



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,  
Kulturë, Rini e Sport  
Mbledhja nr. 33  
Prishtinë, më 21.10.2009 ora 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës  
Salla nr. N- 203

**P R O C E S V E R B A L**

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Veliu, Drita Kadriu, Donika Kadaj-Bujupi, Enis Kervan, Mark Krasniqi Adem Hajdaraj, Hestet Cakolli, dhe Dragan Dimiq.  
Munguan: Gani Buçinca dhe Memli Krasniqi.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Në mbledhje prezantuan përfaqësuesi i OSBE-së, NDI-së, përfaqësuesi nga Presidenca përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.  
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

**Rend dite**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi në parim të Projektligjit për Mërgatën e Kosovës.
4. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

**Agim Veliu** -kryetar, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

## **1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

**Kryesuesi**, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 29.09.2009

## **2. Shqyrtimi në parim të Projektligjit për Mërgatën e Kosovës.**

**Agim Veliu** – kryetari tha se në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit, Komisioni është i obliguar ta shqyrtojë paraprakisht Projektligjin për Mërgatën e Kosovës para se Projektligji të shqyrtohet për herë të parë në Kuvend.

**Kryesuesi** hapi diskutim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

**Donika Kadaj- Bujupi** tha se Projektligji për Mërgatën e Kosovës ka rëndësi të veçantë dhe se për fillimin e amendamentimit të tij nevojitet më shumë kohë. Propozoi që më parë ta lexojmë Projektligjin që në mbledhje të radhës ti paraqesim propozimet tona dhe të caktohet referuesi për vazhdimin e proceduave të mëtejme.

**Mark Krasniqi** theksoi se mërgatës në Kosovë nuk iu është kushtuar kujdes për aq sa është dashur dhe për këtë konsideron se duhet të ketë edhe një Ministri për Mërgatën në Kosovë. Ai tha se në diasporë jetojnë diku rreth 300 mijë njerëz andaj kur bëhet regjistrimi i popullsisë do të paraqiten probleme të shumta. Në vazhdim propozoi që Projektligji duhet mbështetur në parim.

**Kryetari i Komisionit**, duke e ditur se çështja e mërgatës në Kosovë është e një rëndësie të veçantë dhe në bazë të kërkesës së anëtarëve të Komisionit ai konstatoi se më parë duhet të analizohet me përkushtim Projektligjin për Mërgatën e Kosovës dhe më pas Komisioni të dal me propozime konkrete gjatë leximit të parë në Seancë Plenare.

## **2. Të ndryshme.**

Mbledhja e ardhshme e Komisionit do të caktohet me propozim të kryetarit të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 10,25.

Kryetari i Komisionit

---

Agim Veliu